



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 19 paragrafi të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe Rregullores nr.prot.01/172-400 për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të datës 27 shtator 2012, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 06 janar 2021, mori,

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1. Ndahen mjete financiare në shumë 6,000.00€ (gjashtë mijë euro), ndihmë për familjen e z.Blerim Maçastena nga fshati Dumosh, Komuna e Podujevës, anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, i arrestuar, ndaluar dhe paraburgosur nga policia e shtetit Serb në kufirin Kosovë – Serbi më datë 12.12.2020.

2. Ndarja e mjeteve financiare sipas këtij neni bëhet me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të familjes derisa i përmenduri qëndron në mbajtje.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij Vendimi, ndahen nga kategoria Subvencione dhe Transfere n'kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe të njëjtat transferohen në xhironlogarinë bankare nr.13-00-2711008436.17 të familjarit, Hysen Maçastena, vëlla i Blerim Maçastenes.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-400/03-0000854/21
Podujevë,
06 janar 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi